



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES · REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISË · OPSTINA VITINA

Pranuar - Prilbjen Me Datë 07.10.2025			
Nr. i Ottipant Org. Breg	Numri Breg	Shtepaq Prilbje	Vlera Vrednost
01-170/05-1595			



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2 shkronja d, nenit 40, nenit 51 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 36. paragrafi 36.2 shkronja d, lidhur me nenin 44 të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/49, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 29.09.2025, miraton këtë:

V E N D I M

për aprovimin e planit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2026

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton planin e punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2026, për Komunën e Vitisë.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2026 për Komunën e Vitisë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi dhe planin e punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2026 për Komunën e Vitisë do të kujdeset Kryesuesi i Kuvendit dhe kryesuesi i Komitetit për Komunitete.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 10, pika 6 të Ligjit për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Nr. 08/L-284, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.24/27, Dhjetor 2024), dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit;
2. Kryesuesit të Komitetit për Komunitete; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

K R Y E S U E S I

Bekim Azizi